

LIGJ
Nr. 24/2024

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR NJOHJEN E KUALIFIKIMEVE
PROFESIONALE TË INFERMIERËVE, VETERINERËVE, FARMACISTËVE
DHE MAMIVE NË KONTEKSTIN E MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË
TË EVROPËS QENDRORE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja për njohjen e kualifikimeve profesionale të infermierëve, veterinerëve, farmacistëve dhe mamive në kontekstin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 21.3.2024.

Shpallur me dekretin nr. 138, datë 8.4.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

MARRËVESHJE

**PËR NJOHJEN E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE TË INFERMIERËVE,
VETERINERËVE, FARMACISTËVE DHE MAMIVE NË KONTEKSTIN E MARRËVESHJES
SË TREGTISË SË LIRË TË EVROPËS QENDRORE**

Preambulë

Përfaqësuesit e Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës¹, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë (në vijim bashkërisht “Palët” dhe individualisht “Pala”),

në kontekstin e integritetit ekonomik, në përputhje me Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (“CEFTA”) 2006, në përputhje me nenin V të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tregtinë e Shërbimeve, dhe për qëllime të mëtejshme të liberalizimit të tregtisë së shërbimeve brenda CEFTA-s;

duke pasur parasysh qëllimet dhe prioritetet e përcaktuara në Planin e Veprimit të Përbashkët Rajonal të Tregut 2021–2024 (“CRM”), që synon heqjen e pengesave për njohjen e kualifikimeve profesionale, nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të një “Kuardri të Bashkimit Evropian (BE) për njohjen automatike të kualifikimeve profesionale për shtatë profesione dhe sistemin e njohjes automatike të BE-së” bazuar në bashkërendimin e kushteve minimale të trajnimit;

duke vërejtur se asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të interpretohet se i përjashton Palët nga të drejtat dhe detyrimet e tyre përkatëse sipas traktateve ekzistuese;

¹ Ky përcaktim nuk cenon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me rezolutën 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

me synim inkurajimin e mobilitetit të profesionistëve, përputhjen më të mirë të aftësive me nevojat e tregut të punës dhe rritjen e produktivitetit;

duke theksuar objektivat e promovimit të harmonizimit rregullator dhe përafrimit të ligjeve dhe rregulloreve të Palëve me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE); në veçanti, duke synuar mundësimin e lëvizjes së lirë të profesionistëve përmes transpozimit në kuadrin rajonal të Direktivës 2005/36/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 7 shtator 2005, për njohjen e kualifikimeve profesionale, të ndryshuar me *Direktivën 2013/55/BE të Parlamenti Evropian dhe Këshillit, datë 20 nëntor 2013*;

me synimin e sigurimit të njohjes automatike të kualifikimeve profesionale bazuar në kërkesat minimale të trajnimit dhe zbatimit të saj në të katër profesionet e përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe Direktivën e sipërpërmendur dhe caktimin e profesioneve që plotësojnë zbatimin e kërkesave minimale të trajnimit brenda shtojcave në jo më shumë se dy vjet (përveç tre profesioneve të tjera të renditura në *Marrëveshjen për njohjen e kualifikimeve profesionale të mjekëve, stomatologëve dhe arkitektëve në kontekstin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore*, bërë më 3.11.2022),

bien dakord si më poshtë:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Kjo Marrëveshje përcakton rregullat për njohjen automatike të dëshmive të kualifikimeve formale bazuar në kushtet minimale të trajnimit brenda Palëve për akses dhe ushtrim të profesionit të rregulluar, si dhe kushtet minimale të harmonizuara të trajnimit në një ose më shumë Palë të tjera, dhe që lejojnë mbajtësit e kualifikimit në fjalë (në vijim: profesionistët) të ndjekin të njëjtin profesion në një Palë (në vijim: Pala pranuese) të ndryshme nga Pala ku ata kanë marrë kualifikimet e tyre profesionale (në vijim: Pala lëshuese).

Neni 2

Fusha e veprimit

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për personat fizikë, siç përcaktohet në shtojcën I, të Protokollit Shtesë 6, si profesionistë të Palës lëshuese që dëshirojnë të ndjekin një profesion të rregulluar në një Palë pritëse, në bazë të kushteve minimale të harmonizuara të trajnimit, qoftë për një të vetëpunësuar ose të punësuar. Secila Palë do të lejojë një profesionist të Palës lëshuese, me dëshmi të kualifikimeve profesionale dhe formale sipas kuptimit të nenit 3(1)(b), të cilat nuk janë marrë në Palën pritëse, të ndjekë një profesion të rregulluar sipas kuptimit të nenit 3(1)(a) brenda një Pale të tillë, në përputhje me rregullat dhe legjislacionin e saj përkatës. Kjo njohje do të respektojë kushtet minimale të trajnimit të përcaktuara në këtë Marrëveshje. Nëse dëshmitë e kualifikimit formal nuk janë në përputhje me kushtet minimale të trajnimit, siç parashikohen në këtë Marrëveshje, njohja e kualifikimit profesional do t'i nënshtrohet një sistemi të përgjithshëm njohjeje.

2. Kjo Marrëveshje zbatohet për profesionistët e mëposhtëm: infermierët, veterinerë, mamitë dhe farmacistët, siç ato përcaktohen dhe renditen përkatësisht në shtojcën I, shtojcën II, shtojcën III dhe shtojcën IV.

3. Secila Palë do t'i paraqesë Grupit të Përbashkët të Punës për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative që ajo miraton në lidhje me lëshimin e dëshmive të kualifikimeve formale në profesionet e mbuluara nga kjo Marrëveshje.

4. Për qëllime të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, institucionet e arsimit të lartë do të kenë programe studimi të akredituara dhe/ose programe studimi të licencuara të harmonizuara me kërkesat minimale të trajnimit, të përcaktuara në shtojcat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3 Përkufizime

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “profesion i rregulluar”: një veprimtari profesionale ose grup veprimtarish profesionale, qasja në të cilën, ndjekja e së cilës ose një nga mënyrat e ndjekjes së të cilës është objekt, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në bazë të dispozitave legjislative, rregullatore ose administrative, i kualifikimeve specifike profesionale; në veçanti, përdorimi i një titulli profesional të kufizuar nga dispozita legjislative, rregullatore ose administrative për mbajtësit e një kualifikimi të caktuar profesional do të përbëjë një mënyrë ndjekjeje (të profesionit);

b) “kualifikime profesionale”: kualifikime të vërtetuara me dëshmi të kualifikimeve formale, një dëshmi kompetence e lëshuar nga një autoritet kompetent i Palës, i caktuar në përputhje me dispozitat ligjore, rregullatore ose administrative të asaj Pale, në bazë të një kursi trajnimi ose provimi specifik dhe/ose përvojës profesionale;

c) “dëshmi i kualifikimeve formale”: diploma, certifikata dhe dëshmi të tjera të lëshuara nga një autoritet i një Pale të caktuar, në përputhje me dispozitat ligjore, rregullatore ose administrative të asaj Pale dhe që vërtetojnë përfundimin e suksesshëm të trajnimit profesional të marrë kryesisht në një Palë;

d) “autoritet kompetent”: çdo autoritet ose organ i autorizuar nga një Palë në mënyrë specifike për të lëshuar ose marrë diploma trajnimi dhe dokumente ose informacione të tjera, për të marrë aplikimet dhe për të marrë vendimet e përmendura në këtë Marrëveshje;

e) “arsim dhe trajnim i rregulluar”: çdo trajnim i cili është i orientuar në mënyrë specifike për ndjekjen e një profesioni të caktuar dhe që përfshin një kurs ose kurse të plotësuara, sipas rastit, me trajnim profesional, ose praktikë provuese ose profesionale;

f) struktura dhe niveli i formimit profesional, periudhës së provës ose praktikës profesionale do të përcaktohet nga ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative të Palës së interesuar ose të monitoruara, ose miratuara nga autoriteti i caktuar për këtë qëllim;

g) “përvojë profesionale”: ndjekja aktuale dhe e ligjshme me kohë të plotë ose ekuivalente me kohë të pjesshme e profesionit në fjalë në një Palë;

h) “praktikë profesionale”: një periudhë praktike profesionale e kryer nën mbikëqyrje, me kusht që të përbëjë kusht për akses në një profesion të rregulluar dhe që mund të ndodhë ose gjatë, ose pas përfundimit të një arsimimi që çon në një kualifikim;

i) “person fizik” siç përcaktohet në kuadrin e CEFTA-s;

j) “Sistemi Evropian i Transferimit dhe Akumulimit të Kredive ose Krediteve ECTS”: sistemi i krediteve për arsimin e lartë, i përdorur në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë;

k) Grupi i Përbashkët i Punës për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale (GPPNJKP);

l) “CEFTA”: Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore;

m) “RCC”: Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal.

Neni 4 Efektet e njohjes

1. Njohja e kualifikimeve profesionale nga Pala pritëse do t'i lejojë personat fizikë të kenë akses në atë Palë në të njëjtin profesion për të cilin ata janë të kualifikuar në Palën lëshuese dhe ta ushtrojnë atë në Palën pritëse, në kushte jo më pak të favorshme sesa personat fizikë të saj.

KREU II PARIMET E NJOHJES

Neni 5 Rregullat e lidhura me natyrën profesionale, ligjore ose administrative

1. Kur një profesionist lëviz, profesionisti do t'i nënshtrohet rregullave profesionale të një natyre profesionale, ligjore ose administrative, të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me kualifikimet profesionale,

të tilla si: përkufizimi i profesionit, përdorimi i titujve dhe abuzimi i rëndë profesional, i cili lidhet drejtpërdrejt dhe specifikisht me mbrojtjen dhe sigurinë e konsumatorit, si dhe dispozitat disiplinore që zbatohen në Palën pritëse për profesionistët që ndjekin të njëjtin profesion në Palën pritëse.

Neni 6

Parimet e njohjes automatike

1. Secila Palë do të njohë dëshmitë e kualifikimeve formale si infermier përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm si veteriner, si mami dhe si farmacist, të renditura përkatësisht në shtojcën I, shtojcën II, shtojcën III dhe shtojcën IV, të cilët plotësojnë kushtet minimale të trajnimit të përmendura përkatësisht në shtojcën I, shtojcën II, shtojcën III dhe shtojcën IV, dhe për qëllime të aksesit dhe ndjekjes së veprimtarive profesionale, do t'i japin këtyre dëshmimeve të njëjtën fuqi, si dëshmimeve të kualifikimeve formale që lëshon vetë.

Dëshmi të tilla të kualifikimeve formale duhet të lëshohen nga organet kompetente të Palës lëshuese dhe të shoqërohen, sipas rastit, nga certifikatat e renditura përkatësisht në shtojcën I, shtojcën II, shtojcën III dhe shtojcën IV.

2. Këto përditësime nuk do të sjellin një ndryshim të parimeve ekzistuese thelbësore ligjore të Palëve, në lidhje me strukturën e profesioneve mbi trajnimin dhe kushtet e aksesit nga personat fizikë. Këto përditësime do të respektojnë përgjegjësinë e Palëve për organizimin e sistemeve arsimore.

Neni 7

Dispozita të përbashkëta mbi trajnimin

1. Palët, në përputhje me procedurat specifike të secilës Palë, do të sigurojnë, duke inkurajuar zhvillimin e vazhdueshëm profesional, që profesionistët, kualifikimi profesional i të cilëve mbulohet nga kjo Marrëveshje, të jenë në gjendje të përditësojnë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e tyre për të ruajtur një siguri dhe praktikë efektive dhe për t'u përditësuar për zhvillimet profesionale.

Neni 8

Të drejtat e fituara

1. Pa cenuar të drejtat e fituara specifike për profesionet në fjalë, në rastet kur dëshmitë e kualifikimeve formale si infermier përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm, si veteriner, si mami dhe si farmacist që kanë profesionistët e Palëve, nuk plotësojnë të gjitha kërkesat për trajnim të përmendura në këtë Marrëveshje, secila Palë do të njohë si provë të mjaftueshme dëshmitë e kualifikimeve formale të lëshuara nga këto Palë, në masën që këto dëshmi vërtetojnë përfundimin me sukses të trajnimit, i cili fillon në datat që do të propozohen nga Grupi i Përbashkët i Punës dhe shoqërohet me një certifikatë që deklaron se mbajtësit e tyre janë përfshirë efektivisht dhe ligjërisht në veprimtaritë në fjalë për të paktën tre vjet radhazi gjatë pesë viteve para dhënies së certifikatës.

KREU III

PROCEDURA PËR NJOHJEN E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE

Neni 9

Procedura e përbashkët për njohjen e kualifikimeve profesionale

1. Pala pritëse do të njoftojë se e ka marrë kërkesën brenda 30 ditëve nga marrja e saj dhe do të informojë kërkuuesin për çdo dokument që mungon. Nëse kërkuesi nuk e dorëzon dokumentacionin shtesë, autoriteti kompetent e refuzon kërkesën si të paplotë, përveç rastit kur kandidati argumenton arsyet për mosrespektim të afatit.

2. Procedura për shqyrtimin e një kërkesë për autorizim për të ushtruar një profesion të rregulluar duhet të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe të çojë në një vendim të arsyetuar siç duhet nga

autoriteti kompetent në Palën pritëse, në çdo rast brenda tre muajve pas datës kur kërkuesi ka dorëzuar dosjen e plotë dhe në këto raste arsyet do të shpjegohen në vendimin e njohjes.

3. Vendimi ose mungesa e marrjes së një vendimi brenda afatit është objekt ankimi sipas rregullave të përgjithshme të secilës Palë.

Neni 10

Rekursi

1. Njohja e kualifikimeve profesionale do të përfshijë mundësinë për t'iu drejtuar një mekanizmi efektiv rekursi për kërkuesin. Në rast se nuk bëhet njohja, kërkuesi duhet t'i drejtohet një autoriteti, i cili ka përbërje të ndryshme nga autoriteti që ka refuzuar kërkesën. Ky autoritet do të vendosë për ankesën pasi t'i ketë dhënë kërkuesit mundësinë për t'u dëgjuar brenda një kohe të arsyeshme.

Neni 11

Dokumentet dhe certifikatat që mund t'i kërkojnë kërkuesit në përputhje me këtë Marrëveshje

1. Dokumentet

a) Dëshmi se personi në fjalë është person fizik në një Palë.

b) Dëshmi të kualifikimeve formale që japin akses në profesionin e rregulluar në fjalë, siç ato renditen përkatësisht në shtojcën I, shtojcën II, shtojcën III dhe shtojcën IV.

c) Dëshmi të kualifikimit profesional, sipas kuptimit të nenit 3(1)(b), e shoqëruar me certifikatën e autoritetit kompetent që deklaron se profesionisti ka qenë i angazhuar efektivisht dhe ligjërish në veprimtaritë në fjalë për të paktën tre vjet radhazi gjatë pesë viteve para dhënies së certifikatës.

d) Kur autoriteti kompetent i një Pale pritëse kërkon nga personat që dëshirojnë të ushtrojnë një profesion të rregulluar prova se ata kanë karakter ose reputacion të mirë ose se nuk kanë shpallur falimentin, ose nuk janë pezulluar ose ndaluar të ushtrojnë profesionin në rast të abuzimit të rëndë profesional ose një veprë penale, Pala pritëse përkatëse do të pranojë si provë të mjaftueshme, në lidhje me kërkuesit nga Palët që dëshirojnë të ushtrojnë atë profesion, paraqitjen e dokumenteve të lëshuara nga autoritetet kompetente të Palës lëshuese, të cilat tregojnë se këto kërkesa janë përmbushur. Këto autoritete duhet t'i ofrojnë dokumentet brenda një periudhe prej dy muajsh.

e) Kur autoritetet kompetente të Palës lëshuese nuk lëshojnë dokumentet e përmendura në nënparagrafin e parë, këto dokumente do të zëvendësohen me një deklaratë betimi ose, për Palët të cilat nuk kanë dispozitë për deklaratën e betimit, nga një deklaratë solemne, e bërë nga personi fizik në fjalë përpara një autoriteti kompetent gjyqësor ose administrativ ose, sipas rastit, para organit profesional të kualifikuar të Palës lëshuese; ky autoritet lëshon një certifikatë që vërteton vërtetësinë e deklaratës së betimit ose të deklaratës solemne.

f) Kur një Palë pranuese kërkon nga një profesionist i saj që dëshiron të ushtrojë një profesion të rregulluar, një dokument në lidhje me shëndetin fizik ose mendor të kërkuesit, ajo Palë do të pranojë si provë të mjaftueshme paraqitjen e dokumentit të kërkuar nga Pala lëshuese. Kur Pala lëshuese nuk lëshon një dokument të tillë, Pala marrëse do të pranojë një certifikatë të lëshuar nga një autoritet kompetent në atë Palë. Në këtë rast, autoritetet kompetente të Palës lëshuese duhet të japin dokumentin e kërkuar brenda një periudhe njëmuajore.

g) Kur një Palë pranuese kërkon që profesionistët të angazhohen në një profesion të rregulluar, kërkohet:

- deklarata e gjendjes financiare të kërkuesit;

- dëshmi që kërkuesi është i siguruar ndaj rreziqeve financiare që rrjedhin nga përgjegjësia profesionale e profesionistëve, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Palën pritëse, në lidhje me kushtet dhe shtrirjen e mbulimit, ajo Palë do të pranojë si provë të mjaftueshme një vërtetim për këtë qëllim të lëshuar nga bankat dhe shoqëritë e sigurimit të një Pale tjetër.

Kur një Palë e kërkon këtë për profesionistët, do të sigurohet një vërtetim që konfirmon mungesën e pezullimeve të përkohshme ose përfundimtare nga ushtrimi i profesionit, ose mungesën e dënimeve penale.

2. Certifikata të tjera

Për të lehtësuar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët mund të përcaktojnë që përveç dëshmive të kualifikimeve formale, personi fizik që plotëson kushtet e kërkuara të trajnimit, duhet të ofrojë një certifikatë nga autoritetet kompetente të tij/saj dhe çdo Palë tjetër lëshuese që deklaron se kjo dëshmi e kualifikimeve formale plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

3. Format i dhe gjuha

Të gjitha dokumentet dhe certifikatat e përmendura në këtë nen do të pranohen nga autoriteti kompetent i Palës pritëse në formatin dhe gjuhën e përcaktuar në legjislacionin e Palës lëshuese. Pala pritëse ruan të drejtën për të kërkuar përkthimin e dokumenteve dhe certifikatave në një nga gjuhët e saj zyrtare prej kërkuarës.

Neni 12

Përdorimi i titujve profesionalë

a) Nëse, në një Palë pritëse, përdorimi i një titulli profesional në lidhje me një nga veprimtaritë e profesionit në fjalë është i rregulluar, kërkuar nga Pala tjetër, të cilët janë të autorizuar për të ushtruar një profesion të rregulluar, do të përdorin titullin profesional të Palës pritëse, i cili përkon me atë profesion në atë Palë, dhe të përdorë çdo inicial të lidhur.

b) Kur një profesion në Palën pritëse është i rregulluar nga një shoqatë ose organizatë, kërkuar nga Palët nuk do të autorizohen të përdorin titullin profesional të lëshuar nga ajo organizatë ose shoqatë, ose formën e tij të shkurtuar, përveç rasteve kur ata japin prova se janë anëtarë të shoqatës ose organizatës përkatëse.

c) Nëse shoqata ose organizata e kushtëzon anëtarësimin me kualifikime të caktuara, ajo mund ta bëjë këtë, vetëm sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, në lidhje me kërkuarës të Palëve të tjera, të cilët kanë kualifikime profesionale.

Neni 13

Përdorimi i titujve akademikë

Pala pritëse do të sigurojë që personave fizikë të interesuar t'u jepet e drejta për të përdorur titujt akademikë që u janë dhënë në Palën lëshuese dhe një formë të shkurtuar të tyre, në gjuhën e Palës lëshuese. Pala pritëse mund të kërkojë që një titull të pasohet nga emri dhe adresa e dhënies ose e bordit shqyrtues që e ka dhënë atë. Kur një titull akademik i Palës lëshuese mund të ngatërrohet në Palën pritëse me një titull që, në Palën e fundit, kërkon trajnim shtesë që nuk është marrë nga përfutur, Pala pritëse mund t'i kërkojë përfutur të përdorë titullin akademik të Palës lëshuese në një formë të përshtatshme, e cila do të përcaktohet nga Pala pritëse.

KREU IV

RREGULLA TË HOLLËSISHME PËR NDJEKJEN E PROFESIONIT

Neni 14

Njohja e gjuhëve

1. Një Palë, nëse çmohet e nevojshme, do të kërkojë nga ofruesi i shërbimit që përfiton nga njohja e kualifikimeve profesionale, të ketë njohuri të mjaftueshme të gjuhëve të nevojshme për ushtrimin e profesionit në Palën pritëse.

2. Një Palë do të sigurojë që çdo kontroll i kryer për kontrollin e pajtueshmërisë me detyrimin sipas paragrafit 1 do të kufizohet te njohuritë e mjaftueshme të një gjuhe zyrtare të asaj Pale.

3. Çdo kontroll gjuhësor duhet të jetë proporcional me veprimtarinë që do të kryhet. Profesionisti i interesuar do të lejohet të apelojë kontrolle të tilla sipas ligjit të Palës pritëse.

KREU V
BASHKËPUNIMI ADMINISTRATIV

Neni 15

Aksesi qendror në informacion

1. Palët do të sigurojnë që informacioni i mëposhtëm të jetë i disponueshëm publikisht në gjuhën angleze dhe nëpërmjet pikave të kontaktit për shërbimet:

a) një listë të të gjitha profesioneve të rregulluara në atë Palë, duke përfshirë detajet e kontaktit të personave të kontaktit për secilin profesion të rregulluar sipas nenit 18(4);

b) kërkesat dhe procedurat për të gjitha profesionet e rregulluara në atë Palë, duke përfshirë të gjitha tarifat përkatëse që duhet të paguhet nga personat fizikë dhe dokumentet që do të dorëzohen nga personat fizikë;

c) detaje sesi të apelohej, sipas ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative, vendimet e Palëve të miratuara në lidhje me këtë Marrëveshje.

2. Palët do të sigurojnë që informacioni i përmendur në paragrafin 1 të ofrohet në mënyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse, dhe që të jetë lehtësisht i aksesueshëm në distancë dhe me mjete elektronike, dhe që të mbahet i përditësuar.

3. Palët do të sigurojnë që çdo kërkesë për informacion, drejtuar pikave të kontaktit për shërbimet, t'i jepet përgjigje sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 16

Grupi i Përbashkët i Punës për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale

1. Grupi i Përbashkët i Punës për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale (GPPNJKP) do të lehtësojë dhe mbikëqyrë zbatimin dhe vënien në jetë të kësaj Marrëveshjeje.

2. Anëtarët e GPPNJKP-së, ndër të tjera, do të ngarkohen me dhënien e informacionit dhe asistencës siç është e nevojshme në lidhje me njohjen e kualifikimeve profesionale të parashikuara në këtë Marrëveshje, të tilla si informacion mbi legjislacionin, rregulloret dhe dispozitat administrative që rregullojnë njohjen e kualifikimeve të profesionistëve.

3. Termat e referencës së GPPNJKP-së do të miratohen jo më vonë se një vit pas miratimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17

Transparenca

1. Palët do t'i japin GPPNJKP-së një listë të të gjitha profesioneve ekzistuese të rregulluara, duke specifikuar veprimtaritë e mbuluara nga secili profesion, dhe një listë të arsimit dhe trajnimit të rregulluar, dhe trajnimit me një strukturë të posaçme, jo më vonë se 18 muaj pas miratimit të kësaj Marrëveshjeje. Çdo ndryshim në ato lista do t'i njoftohet gjithashtu GPPNJKP-së pa vonesa të panevojshme. Sekretariatet e CEFTA-s dhe RCC-së do të krijojnë dhe mbajnë një bazë të dhënash publike të profesioneve të rregulluara, duke përfshirë një përshkrim të përgjithshëm të veprimtarive të mbuluara nga secili profesion.

2. Palët do të shqyrtojnë nëse kërkesat sipas sistemit të tyre ligjor kufizojnë aksesin në një profesion ose ndjekjen e tij për mbajtësit e një kualifikimi specifik profesional, duke përfshirë përdorimin e titujve profesionalë dhe veprimtaritë profesionale të lejuara sipas këtij titulli, të përmendura në këtë nen si "kërkesat" janë në përputhje me parimet e mëposhtme:

a) kërkesat nuk duhet të jenë as drejtpërdrejt, as tërthorazi diskriminuese;

b) kërkesat duhet të justifikohen nga arsye kryesore të interesit të përgjithshëm;

c) kërkesat duhet të jenë të përshtatshme për të garantuar arritjen e objektivit të ndjekur dhe nuk duhet të tejkalojnë çka është e nevojshme për të arritur atë objektiv;

d) Palët do të informojnë GPPNJKP-në për gjetjet e tyre.

Neni 18

Parimet e bashkëpunimit administrativ

1. Palët do të punojnë në bashkëpunim të ngushtë dhe do të ofrojnë ndihmë reciproke për të lehtësuar zbatimin dhe vënien në jetë të kësaj Marrëveshjeje. Ato duhet të sigurojnë konfidencialitetin e informacionit që shkëmbejnë.

2. Nëpërmjet GPPNJKP-së, Palët do të shkëmbejnë informacionin që çmojnë të nevojshëm për ndjekjen e veprimtarive sipas kësaj Marrëveshjeje. Duke vepruar në këtë mënyrë, ato do të respektojnë rregullat e mbrojtjes së të dhënave personale të parashikuara në legjislacionin përkatës të Palëve.

3. Secila Palë do të shkëmbejë informacion me Palët e tjera nëpërmjet GPPNJKP-së mbi proceset me anë të së cilave ato do të japin ose marrin dëshmi të kualifikimeve formale dhe dokumente ose informacione të tjera, dhe do të marrin kërkesa dhe do të marrin vendimet e përmendura në këtë Marrëveshje.

4. Nëpërmjet GPPNJKP-në, secila Palë do t'u sigurojë Palëve të tjera emrin e një personi kontakti për secilin profesion të rregulluar, i cili do të sigurojë të gjithë informacionin përkatës dhe do të mbështesë bashkëpunimin ndërmjet Palëve në lidhje me profesionin e rregulluar specifik përkatës.

KREU VI

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 19

Transpozimi

1. Palët do të miratojnë ligje, rregullore dhe dispozita administrative të nevojshme për të qenë në përputhje me këtë Marrëveshje jo më vonë se tetëmbëdhjetë muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje sipas nenit 21 të saj. Palët do të informojnë GPPNJKP-në për këtë.

Neni 20

Shtojcat

1. Të gjitha shtojcat janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

2. Informacioni që duhet të ofrohet nga Palët në shtojcën I, shtojcën II, shtojcën III dhe shtojcën IV do të sigurohet nga autoritetet kompetente dhe do t'i dorëzohet GPPNJKP-së jo më vonë se 18 muaj pasi kjo Marrëveshje të ketë hyrë në fuqi, sipas nenit 21 të saj.

3. Palët do të sigurojnë që informacioni i dhënë në shtojcën I, shtojcën II, shtojcën III dhe shtojcën IV të mbahet i përditësuar dhe të ndryshohet sipas nevojës nga GPPNJKP-ja, në përputhje me nenin 6(1)(2) të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 21

Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit, pranimi ose miratimit në përputhje me kërkesat përkatëse të parashikuara nga legjislacioni i Palëve. Njoftimi zyrtar i ratifikimit, pranimi ose miratimit do të depozitohet te depozitari.

2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit të njoftimit të tretë formal të ratifikimit, pranimi ose miratimit për Palët që kanë depozituar njoftimin e tyre formal të ratifikimit, pranimi ose miratimit.

3. Për çdo Palë që depoziton njoftimin e saj zyrtar të ratifikimit, pranimi ose miratimit pas datës së depozitimit të njoftimit të tretë zyrtar të ratifikimit, pranimi ose miratimit, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës në të cilën Pala përkatëse depoziton njoftimin e saj zyrtar të ratifikimit, pranimi ose miratimit.

4. Maqedonia e Veriut do të veprojë si depozitar dhe do të njoftojë të gjitha palët në këtë Marrëveshje për çdo njoftim të marrë në përputhje me këtë nen dhe çdo akt ose njoftim tjetër në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 22
Ndryshimet

1. Secila Palë mund të propozojë ndryshime në Marrëveshje duke i dërguar një njoftim me shkrim depozitarit. Depozitari do t'ia referojë këtë njoftim GPPNJKP-së së përmendur në nenin 16 të kësaj Marrëveshjeje.
2. Propozimet e ndryshimeve do të miratohen me konsensus të të gjithë anëtarëve të GPPNJKP-së. Këto propozime do t'i referohen organit përgjegjës të CEFTA-s për Tregtinë e Shërbimeve.
3. Kur të miratohen, ndryshimet do t'u paraqiten Palëve për ratifikim ose miratim.
4. Ndryshimet hyjnë në fuqi në përputhje me rregullat dhe procedurën e përcaktuar në nenin 21.

Neni 23
Kohëzgjatja dhe denoncimi

1. Kjo Marrëveshje nënshkruhet për një periudhë të papërcaktuar kohe.
2. Çdo Palë, në çdo kohë, mund të denoncojë Marrëveshjen duke i bërë njoftim me shkrim depozitarit, i cili do të njoftojë Palët e tjera për këtë denoncim.
3. Ky denoncim do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas datës kur njoftohet depozitari.

Neni 24
Zgjidhja e Marrëveshjes

Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga kjo Marrëveshje do të zgjidhen nëpërmjet Mekanizmit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve CEFTA 2006.

Neni 25
Aderimi nga Palët e CEFTA-s

Palët njohin të drejtat e çdo Pale të CEFTA-s për aderim në këtë Marrëveshje. Marrëveshja hartohet në gjuhën angleze në versionin origjinal, i cili do të mbetet në zotërim të depozitarit. Secila Palë do të marrë një kopje të certifikuar të Marrëveshjes.

(Nënshkrimet)

NJOHJA NË BAZË TË KOORDINIMIT TË KUSHTEVE MINIMALE TË TRAJNIMIT

SHTOJCA I

INFERMIERËT PËRGJEGJËS PËR KUJDESIN E PËRGJITHSHËM

Të gjitha dispozitat në shtojcën I janë marrë nga Direktiva e BE-së 2005/36/KE, "Për njohjen e kualifikimeve profesionale", e ndryshuar nga Direktiva e BE-së 2013/55/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 nëntor 2013.

Neni 1

Trajnimi i infermierëve përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm

1. Pranimi për trajnim për infermierë përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm varet nga zotërimi i kualifikimit ose certifikatës që garanton akses, për studimet në fjalë, në universitete, institucione të arsimit të lartë të një niveli të njohur si ekuivalent, ose në shkollat profesionale, ose nëpërmjet programeve të formimit profesional për infermieri.

2. Trajnimi i infermierëve përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm do të bëhet me kohë të plotë dhe do të përfshijë të paktën programin e përshkruar në nenin 3, të shtojcës I.

3. Trajnimi i infermierëve përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm do të përfshijë gjithsej të paktën tre vite studimi, të cilat mund të shprehen më tej me kredite ekuivalente ECTS dhe do të përbëhet nga të paktën 4 600 orë trajnimesh teorike dhe klinike, me kohëzgjatjen e trajnimit teorik që përfaqëson të paktën një të tretën dhe kohëzgjatjen e trajnimit klinik të paktën gjysmën e kohëzgjatjes minimale të trajnimit. Palët mund të miratojnë përjashtime të pjesshme për profesionistët që kanë marrë një pjesë të trajnimit të tyre në kurse të cilat janë të paktën të një niveli ekuivalent.

Palët do të sigurojnë që institucionet që ofrojnë trajnime infermierie të jenë përgjegjëse për koordinimin e trajnimit teorik dhe klinik gjatë të gjithë programit të studimit.

4. Edukimi teorik është ajo pjesë e trajnimit të infermierit nga e cila infermierët praktikantë fitojnë njohuritë profesionale, aftësitë dhe kompetencat e kërkuara sipas paragrafëve 6 dhe 7. Trajnimi do të jepet nga mësuesit e kujdesit infermior dhe nga persona të tjerë kompetentë, në universitete, arsimin e lartë, institucione të një niveli të njohura si ekuivalente ose në shkolla profesionale, ose nëpërmjet programeve të formimit profesional për infermieri.

5. Trajnimi klinik është ajo pjesë e trajnimit të infermierëve ku infermierët praktikantë mësojnë, si pjesë e ekipi dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me një individ dhe/ose komunitet të shëndetshëm ose të sëmurë, të organizojnë, shpërndajnë dhe vlerësojnë kujdesin e nevojshëm gjithëpërfshirës infermior, mbi bazën e njohurive, aftësive dhe kompetencave që kanë fituar. Infermieri praktikant mëson jo vetëm si të punojë në ekip, por edhe si të drejtojë një ekip dhe të organizojë kujdesin e përgjithshëm infermior, duke përfshirë edukimin shëndetësor për individë dhe grupe të vogla, brenda instituteve shëndetësore ose në komunitet.

6. Trajnimi për infermierët përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm ofron siguri që profesionisti në fjalë ka fituar njohuritë dhe aftësitë e mëposhtme:

a) njohuri gjithëpërfshirëse të shkencave ku bazohet infermiera e përgjithshme, duke përfshirë kuptimin e mjaftueshëm të strukturës, funksioneve fiziologjike dhe sjelljes së personave të shëndetshëm dhe të sëmurë, dhe të marrëdhënies ndërmjet gjendjes shëndetësore dhe mjedisit fizik dhe social të qenies njerëzore;

b) njohuri mbi natyrën dhe etikën e profesionit dhe njohuri për parimet e përgjithshme të shëndetit dhe infermierisë;

c) përvojë të përshtatshme klinike; një përvojë e tillë, e cila duhet të zgjidhet për vlerën e saj të trajnimit, duhet të fitohet nën mbikëqyrjen e personelit të kualifikuar infermior dhe në vendet ku numri i personelit të kualifikuar dhe pajisjet e disponueshme janë të përshtatshme për kujdesin infermior të pacientit;

d) aftësinë për të marrë pjesë në trajnime praktike të personelit shëndetësor dhe përvojën e punës me personelin e tillë;

e) përvojën e punës së bashku me anëtarë të profesioneve të tjera në sektorin e shëndetësisë.

7. Kualifikimet formale si infermier përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm duhet të dëshmojnë se profesionisti në fjalë është në gjendje të zbatojë të paktën kompetencat e mëposhtme, pavarësisht nëse trajnimi është kryer në universitete, institucione të arsimit të lartë të një niveli të njohur si ekuivalent apo shkolla profesionale, ose nëpërmjet programeve të formimit profesional për infermier:

a) kompetenca për të diagnostikuar në mënyrë të pavarur kujdesin infermior të kërkuar, duke përdorur njohuritë aktuale teorike dhe klinike dhe për të planifikuar, organizuar dhe zbatuar kujdesin infermior gjatë trajtimit të pacientëve në bazë të njohurive dhe aftësive të fituara, në përputhje me pikat “a”, “b” dhe “c”, të paragrafit 4, me qëllim përmirësimin e praktikës profesionale;

b) kompetenca për të punuar së bashku në mënyrë efektive me aktorë të tjerë në sektorin shëndetësor, duke përfshirë pjesëmarrjen në trajnime praktike të personelit shëndetësor, në bazë të njohurive dhe aftësive të fituara, në përputhje me pikat “d” dhe “e”, të paragrafit 4;

c) kompetenca për të fuqizuar individët, familjet dhe grupet drejt një stili të shëndetshëm jetese dhe të kujdesit për veten në bazë të njohurive dhe aftësive të fituara, në përputhje me pikat “a” dhe “b”, të paragrafit 4;

d) kompetenca për të nisur në mënyrë të pavarur masa të menjëhershme për ruajtjen e jetës dhe për të marrë masa në situata krizash dhe fatkeqësish;

e) kompetenca për të dhënë këshilla, udhëzuar dhe mbështetur në mënyrë të pavarur personat që kanë nevojë për kujdes dhe figura të lidhura me ta;

f) kompetenca për të garantuar në mënyrë të pavarur cilësinë dhe për të vlerësuar kujdesin infermior;

g) kompetenca për të komunikuar në mënyrë gjithëpërfshirëse, në mënyrë profesionale dhe për të bashkëpunuar me anëtarë të profesioneve të tjera në sektorin e shëndetësisë;

h) kompetenca për të analizuar cilësinë e kujdesit për të përmirësuar praktikën profesionale si infermier përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm.

Neni 2

Ndjekja e veprimtarive profesionale të infermierëve përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, veprimtaritë profesionale të infermierëve përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm janë veprimtaritë e ndjekura mbi baza profesionale dhe të përmendura në nenin 3 të shtojcës I.

Palët mund të parashikojnë, në legjislacionin përkatës, përjashtime të pjesshme nga pjesët e programit të trajnimit për infermierë përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm, të renditura në nenin 3, të shtojcës I, që do të zbatohen rast pas rasti, me kusht që ajo pjesë e trajnimit të jetë ndjekur gjatë një kursi tjetër trajnimi të specializuar, të renditur në nenin 3, të shtojcës I, për të cilin profesionisti ka marrë tashmë kualifikimin profesional në një shtet Palë. Palët do të sigurojnë që përjashtimi i miratuar të barazohet me jo më shumë se gjysmën e kohëzgjatjes minimale të kursit të trajnimit në fjalë.

Çdo Palë do të njoftojë Grupin e Përbashkët të Punës dhe Palët e tjera për legjislacionin e saj përkatës për çdo përjashtim të tillë të pjesshëm.

Palët do të kushtëzojnë lëshimin e provave të trajnimit mjekësor të specializuar me zotërimin e provave të trajnimit bazë mjekësor, të përmendur në nenin 3, të shtojcës I.

Neni 3

Programi i trajnimit për infermierët përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm

1. Trajnimi që çon në dhënien e një kualifikimi formal të infermierëve përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm, do të përbëhet nga dy pjesët e mëposhtme:

A. Lëndë teorike

a) Infermiera:

- Natyra dhe etika e profesionit;
- Parimet e përgjithshme të shëndetit dhe infermierisë;
- Parimet e infermierisë në lidhje me:
- mjekësinë e përgjithshme dhe të specializuar;

- kirurgjinë e përgjithshme dhe të specializuar;
- kujdesin për fëmijët dhe pediatriinë;
- kujdesin në maternitet;
- shëndetin mendor dhe psikiatriinë;
- kujdesin për të moshuarit dhe gjeriatriinë;

b) Shkencat bazë:

- Anatomi dhe fiziologji;
- Patologji;
- Bakteriologji, virologji dhe parazitologji;
- Biofizikë, biokimi dhe radiologji;
- Dietologji;
- Higjienë:

- mjekësi parandaluese,
- edukim shëndetësor,

- Farmakologji;

c) Shkencat shoqërore:

- Sociologji;
- Psikologji;
- Parimet e administrimit;
- Parimet e mësimdhënies;
- Legjislacioni social dhe shëndetësor;
- Aspektet ligjore të infermierisë.

B. Udhëzime klinike:

- Infermiera në lidhje me:
- mjekësinë e përgjithshme dhe të specializuar;
- kirurgjinë e përgjithshme dhe të specializuar;
- kujdesin për fëmijët dhe pediatriinë;
- kujdesin në maternitet;
- shëndetin mendor dhe psikiatriinë;
- kujdesin për të moshuarit dhe gjeriatriinë;
- infermierinë në shtëpi.

2. Një ose më shumë nga këto lëndë mund të mësohen në kontekstin e disiplinave të tjera ose në lidhje me to.

3. Lëndët teorike duhet të peshohen dhe koordinohen me lëndët klinike, në mënyrë që njohuritë dhe aftësitë e përmendura në këtë shtojcë të mund të fitohen në mënyrën e duhur.

Neni 4

Dëshmi të kualifikimeve formale të infermierëve përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm

Pala	Dëshmia e kualifikimeve formale	Organi që jep kualifikimet	Titulli profesional	Data e referencës

SHTOJCA II

VETERINERËT

Të gjitha dispozitat në shtojcën II janë marrë nga Direktiva e BE-së 2005/36/KE, "Për njohjen e kualifikimeve profesionale", e ndryshuar nga Direktiva e BE-së 2013/55/BE e Parlamentit Evropian dhe e Kështillit, datë 20 nëntor 2013.

Neni 1

Trajnimi i veterinerëve

1. Trajnimi i veterinerëve përfshin gjithsej të paktën pesë vite studim teorik dhe praktik me kohë të plotë, të cilat mund të shprehen gjithashtu me kredite ekuivalente ECTS, në një universitet ose në një institut të lartë që ofron trajnim të njohur si të një niveli ekuivalent, ose nën mbikëqyrjen e një universiteti që mbulon të paktën programin e studimit të përmendur në nenin 3, të shtojcës II.

2. Pranimi në trajnimin veterinar do të kushtëzohet me zotërimin e një diplome ose certificate që i jep të drejtë mbajtësit të hyjë, për studimet në fjalë, në universitete ose institucione të arsimit të lartë të njohura si të një niveli ekuivalent për qëllimin e studimit përkatës.

3. Trajnimi si veteriner ofron siguri se profesionisti në fjalë ka fituar njohuritë dhe aftësitë e mëposhtme:

a) njohuri të mjaftueshme të shkencave ku bazohen veprimtaritë e një veterineri dhe të ligjit përkatës të Palës, në lidhje me këto veprimtari;

b) njohuri të përshtatshme mbi strukturën, funksionet, sjelljen dhe nevojat fiziologjike të kafshëve, si dhe aftësi dhe kompetenca të nevojshme për mbarështimin, ushqimin, mirëqenien, riprodhimin dhe higjienën e tyre në përgjithësi;

c) aftësi dhe kompetenca klinike, epidemiologjike dhe analitike të nevojshme për parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve të kafshëve, duke përfshirë anestezinë, kirurgjinë aseptike dhe vdekjen pa dhimbje, nëse ato konsiderohen individualisht ose në grup, duke përfshirë njohuritë specifike të sëmundjeve që mund të transmetohet te njerëzit;

d) njohuri, aftësi dhe kompetenca të duhura për mjekësinë parandaluese, duke përfshirë kompetencat në lidhje me hetimet dhe certifikimin;

e) njohuri të përshtatshme për higjienën dhe teknologjinë e përfshirë në prodhimin, dhe hedhjen në qarkullim të ushqimeve për kafshë ose ushqimeve me origjinë shtazore të destinuara për konsum njerëzor, duke përfshirë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të kuptuar dhe shpjeguar praktikën e mira në këtë drejtim;

f) njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për përdorimin e përgjegjshëm dhe të arsyeshëm të produkteve mjekësore veterinarë, me qëllim trajtimin e kafshëve dhe për të garantuar sigurinë e zinxhirit ushqimor dhe mbrojtjen e mjedisit.

Neni 2

Të drejtat e përfituara të lidhura me veterinerët

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, dëshmitë e kualifikimeve formale si veteriner janë veprimtaritë e ndjekura mbi baza profesionale dhe të përmendura në nenin 3, të shtojcës II.

Palët mund të parashikojnë, në legjislacionin përkatës, përjashtime të pjesshme nga pjesët e studimeve të programit që çojnë në dëshminë e kualifikimeve formale në mjekësinë veterinarë, të renditura në nenin 3 të shtojcës II, të cilat do të zbatohen rast pas rasti, me kusht që ajo pjesë e trajnimit të jetë ndjekur gjatë një kursi tjetër trajnimi të specializuar, të renditur në nenin 3, të shtojcës II, për të cilin profesionisti ka marrë tashmë kualifikimin profesional në një Palë. Palët do të sigurojnë që përjashtimi i lejuar të barazohet me jo më shumë se gjysmën e kohëzgjatjes minimale të kursit të trajnimit në fjalë.

Çdo Palë do të njoftojë Grupin e Përbashkët të Punës dhe Palët e tjera për legjislacionin e saj në fjalë për çdo përjashtim të tillë të pjesshëm.

Palët do të kushtëzojnë lëshimin e provave të trajnimit mjekësor veterinar me zotërimin e provave të trajnimit bazë mjekësor të përmendur në nenin 3, të shtojcës II.

Neni 3

Programi i studimit për veterinarinë

Programi i studimeve që çon në evidentimin e kualifikimeve formale në mjekësinë veterinarë, duhet të përfshijë të paktën lëndët e renditura më poshtë.

Mësimi në një ose më shumë nga këto lëndë mund të jepet si pjesë ose në bashkëpunim me kurse të tjera.

A. Lëndët bazë:

- Fizika;
- Kimia;
- Biologjia e kafshëve;
- Biologjia e bimëve;
- Biomatematika.

B. Lëndë specifike

a) Shkenca bazë:

- Anatomi (duke përfshirë histologjinë dhe embriologjinë);
- Fiziologji;
- Biokimi;
- Gjenetikë;
- Farmakologji;
- Farmaci;
- Toksikologji;
- Mikrobiologji;
- Immunologji;
- Epidemiologji;
- Etikë profesionale;

b) Shkenca klinike:

- Obstetrikë;
- Patologji (duke përfshirë anatominë patologjike);
- Parazitologji;
- Mjekësi dhe kirurgji klinike (duke përfshirë anestezinë);
- Leksione klinike mbi kafshët e ndryshme shtëpiake, shpendët dhe specie kafshësh të tjera;
- Mjekësi parandaluese;
- Radiologji;
- Riprodhim dhe çrregullimet riprodhuese;
- Mjekësi veterinar publike dhe shëndet publik;
- Legjislacion veterinar dhe mjekësi mjeko-ligjore;
- Terapeutikë;
- Propedeutikë;

c) Prodhimi i kafshëve:

- Prodhimi i kafshëve;
- Ushqimi i kafshëve;
- Agronomi;
- Ekonomi rurale;
- Mbarështimi i kafshëve;
- Higjienë veterinarë;
- Etologjia dhe mbrojtja e kafshëve;

d) Higjiena ushqimore:

- Inspektim dhe kontroll i produkteve ushqimore shtazore apo ushqimeve me origjinë shtazore;
- Higjiena dhe teknologjia ushqimore;
- Punë praktike (përfshirë punën praktike në vendet ku bëhet therja dhe përpunimi i produkteve ushqimore.

Trajnimi praktik mund të jetë në formën e një periudhe trajnimi, me kusht që një trajnim i tillë të jetë me kohë të plotë, të kryhet nën kontrollin e drejtpërdrejtë të autoritetit kompetent dhe të mos kalojë gjashtë muaj brenda periudhës së përgjithshme të trajnimit prej pesë vitesh studimi.

Shpërndarja e trajnimit teorik dhe praktik midis grupeve të ndryshme të lëndëve duhet të jetë e balancuar dhe e koordinuar në mënyrë që njohuritë dhe përvoja të mund të fitohen që t'u mundësojë veterinerëve të kryejnë të gjitha detyrat e tyre.

Neni 4

Dëshmi të kualifikimeve formale të veterinerëve

Pala	Dëshmia e kualifikimeve formale	Organi që jep kualifikimet	Titulli profesional	Data e referencës

SHTOJCA III

MAMITË

Të gjitha dispozitat në shtojcën III janë marrë nga Direktiva e BE-së 2005/36/KE, "Për njohjen e kualifikimeve profesionale", e ndryshuar nga Direktiva e BE-së 2013/55/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 nëntor 2013.

Neni 1

Trajnimi i mamive

1. Trajnimi i mamive duhet të përfshijë gjithsej të paktën:

a) trajnim specifik me kohë të plotë si mami që përfshin të paktën tre vjet studim teorik dhe praktik (rruga I), i cili përfshin të paktën programin e përshkruar në nenin 4, të shtojcës III; ose

b) trajnim specifik me kohë të plotë si mami me kohëzgjatje prej 18 muajsh (rruga II) që përfshin të paktën programin e studimit të përshkruar në nenin 4, të shtojcës III, i cili nuk është objekt i trajnimit ekuivalent të infermierëve përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm.

Palët do të sigurojnë që institucionet që ofrojnë trajnime për mamitë janë përgjegjëse për koordinimin e teorisë dhe praktikës gjatë të gjithë programit të studimit.

2. Pranimi në trajnimin si mami kushtëzohet nga një nga kushtet e mëposhtme:

a) zotërimi i kualifikimit ose certifikatës që siguron akses, për studimet në fjalë, për pranim në një shkollë për mami për rrugën I;

b) zotërimi i dëshmive të kualifikimeve formale si infermiere përgjegjëse për kujdesin e përgjithshëm të përmendur në nenin 4, të shtojcës III, për rrugën II.

3. Trajnimi si mami ofron siguri se profesionisti në fjalë ka fituar njohuritë dhe aftësitë e mëposhtme:

a) njohuri të hollësishme të shkencave mbi të cilat bazohen veprimtaritë e mamive, veçanërisht ndërhyrjet e mamive, obstetrikën dhe gjinekologjinë;

b) njohuri të përshtatshme për etikën e profesionit dhe legjislacionin përkatës për ushtrimin e profesionit;

c) njohuri të përshtatshme për njohuritë e përgjithshme mjekësore (funksionet biologjike, anatominë dhe fiziologjinë) dhe farmakologjinë në fushën e obstetrikës dhe të të porsalindurve, si dhe njohuri për marrëdhëniet midis gjendjes shëndetësore dhe mjedisit fizik, dhe social të qenies njerëzore dhe sjelljes së tij;

d) përvojë të përshtatshme klinike të fituar në institucione të miratuara që i mundëson mamisë të jetë në gjendje, në mënyrë të pavarur dhe nën përgjegjësinë e saj, në masën e nevojshme dhe duke përjashtuar situatat patologjike, të menaxhojë kujdesin para lindjes, të kryejë lindjen dhe pasojat e tij në institucionet e miratuara; dhe të mbikëqyrë procesin e lindjes për nënën dhe foshnjën, kujdesin pas lindjes dhe reanimacionin neonatal gjatë pritjes së mjekut;

e) të kuptuarit e duhur të trajnimit të personelit shëndetësor dhe përvojës së punës me personelin shëndetësor.

Neni 2

Procedurat për njohjen e dëshmive të kualifikimeve formale si mami

1. Dëshmitë e kualifikimeve formale si mami, përmendur në nenin 4, të shtojcës III, do t'i nënshtrohet njohjes automatike në masën që ato plotësojnë një nga kriteret e mëposhtme:

a) trajnimin me kohë të plotë prej të paktën tre vjet si mami, i cili mund të shprehet gjithashtu me kredite ekuivalente ECTS, i përbërë nga të paktën 4 600 orë trajnim teorik dhe praktik, me të paktën një të tretën e kohëzgjatjes minimale, përfaqëson trajnimin klinik;

b) trajnimin me kohë të plotë si mami prej të paktën dy vjet, i cili mund të shprehet gjithashtu me kredite ekuivalente ECTS, të përbërë nga të paktën 3 600 orë, në varësi të zotërimit të provave të kualifikimeve formale si infermiere përgjegjëse për kujdesin e përmendur në nenin 4, në shtojcën III;

c) trajnimin me kohë të plotë si mami prej të paktën 18 muajsh, i cili përveç kësaj mund të shprehet me kredite ekuivalente ECTS, të përbërë nga të paktën 3 000 orë, në varësi të zotërimit të provave të kualifikimeve formale si infermiere përgjegjëse për kujdesin e përmendur në nenin 4, të shtojcës III, dhe të pasuar nga praktika profesionale njëvjeçare për të cilën është lëshuar një certifikatë, në përputhje me paragrafin 2.

2. Certifikata e përmendur në paragrafin 1 do të lëshohet nga autoritetet kompetente në Palët. Ajo vërteton se mbajtësi, pasi të ketë marrë dëshmi të kualifikimeve formale si mami, ka ndjekur në mënyrë të kënaqshme të gjitha veprimtaritë e një mamie për një periudhë korresponduese në një spital ose një institucion të kujdesit shëndetësor të miratuar për këtë qëllim.

Neni 3

Ndjekja e veprimtarive profesionale si mami

1. Dispozitat e këtij seksioni do të zbatohen për veprimtaritë e mamive të përcaktuara nga secila Palë, pa cenuar paragrafin 2, dhe të ndjekura sipas titujve profesionalë të përcaktuar në nenin 4, të shtojcës III.

2. Palët do të sigurojnë që mamitë të jenë në gjendje të kenë akses dhe të ndjekin të paktën veprimtaritë e mëposhtme:

a) ofrimin e informacionit dhe këshillave të qëndrueshme për planifikimin familjar;

b) diagnostikimin e shtatzënive dhe monitorimin e shtatzënive normale; kryerjen e ekzaminimeve të nevojshme për monitorimin e zhvillimit të shtatzënive normale;

c) përshkrimin ose këshillimin për ekzaminimet e nevojshme për diagnostikimin sa më të hershëm të shtatzënive në rrezik;

d) ofrimin e programeve të përgatitjes për prindërim dhe përgatitjes së plotë për lindjen e fëmijës, duke përfshirë këshilla për higjienën dhe ushqimin;

e) kujdesin dhe asistimin e nënës gjatë lindjes dhe monitorimin e gjendjes së fetusit në mitër me mjetet e duhura klinike dhe teknike;

f) kryerjen e lindjeve spontane, duke përfshirë aty ku kërkohet, epiziotomitë dhe në raste urgjente të lindjeve podalike;

g) njohjen e shenjave paralajmëruese të anomalive për nënën ose foshnjën, të cilat kërkojnë referimin te mjeku dhe ndihmën e këtij të fundit sipas rastit; marrjen e masave të nevojshme urgjente në mungesë të mjekut, veçanërisht për heqjen manuale të placentës, e ndjekur ndoshta nga ekzaminimi manual i mitrës;

h) ekzaminimin dhe kujdesin për foshnjën e porsalindur; marrjen e të gjitha iniciativave të nevojshme në rast nevojë dhe kryerjen e reanimacionit të menjëhershëm sipas nevojës;

i) kujdesin dhe monitorimin e progresit të nënës në periudhën pas lindjes dhe dhënien e të gjitha këshillave të nevojshme nënës për kujdesin ndaj foshnjës, për t'i mundësuar asaj të sigurojë përparimin optimal të foshnjës së porsalindur;

j) kryerjen e trajtimit të përshkruar nga mjekët;

k) hartimin e raporteve të nevojshme me shkrim.

3. Palët mund të parashikojnë, në legjislacionet përkatëse, përjashtime të pjesëshme nga pjesët e programit të trajnimit për mamitë, të renditura në nenin 4, të shtojcës III, për t'u zbatuar rast pas rasti, me kusht që ajo pjesë e trajnimit të jetë ndjekur gjatë një kursi tjetër trajnimi të specializuar, të renditur

në nenin 4, të shtojcës III, për të cilin profesionisti ka marrë tashmë kualifikimin profesional në një Palë. Palët do të sigurojnë që përjashtimi i lejuar të barazohet me jo më shumë se gjysmën e kohëzgjatjes minimale të kursit të trajnimit në fjalë.

Çdo Palë do të njoftojë Grupin e Përbashkët të Punës dhe Palët e tjera për legjislacionin e lidhur me çdo përjashtim të tillë të pjesshëm.

Palët do të kushtëzojnë lëshimin e provave të trajnimit mjekësor të specializuar me zotërimin e provave të trajnimit bazë mjekësor, të përmendur në nenin 5, të shtojcës III.

Neni 4

Programi i trajnimit për mami (tipi I dhe II i trajnimit)

Programi i trajnimit për marrjen e dëshmive të kualifikimeve formale për mami përbëhet nga dy pjesët e mëposhtme:

A. Mësim teorik dhe teknik

a) Lëndët e përgjithshme:

- Anatomi dhe fiziologji bazë;
- Patologji bazë;
- Bakteriologji, virologji dhe parazitologji bazë;
- Biofizikë, biokimi dhe radiologji bazë;
- Higjienë, edukim shëndetësor, mjekësi parandaluese, diagnostikim i hershëm i sëmundjeve;
- Të ushqyerit dhe dietat, duke u përqendruar veçanërisht te gratë, të sapolindurit dhe foshnjat e vogla;
- Pyetje bazë të sociologjisë dhe socio-mjekësore;
- Farmakologji bazë;
- Psikologji;
- Parimet dhe metodat e mësimdhënies;
- Legjislacioni shëndetësor dhe social, dhe organizimi shëndetësor;
- Etika profesionale dhe legjislacioni profesional;
- Edukimi seksual dhe planifikimi familjar;
- Mbrojtja ligjore e nënës dhe foshnjës;

b) Lëndë që lidhen konkretisht me veprimtaritë e mamive:

- Anatomi dhe fiziologji;
- Embriologjia dhe zhvillimi i fetusit;
- Shtatzënia, lindja dhe puerperiumi;
- Patologji gjinekologjike dhe obstetrike;
- Përgatitje për lindjen dhe prindërimin, duke përfshirë aspektet psikologjike;
- Përgatitje për lindje (përfshirë njohuritë dhe përdorimin e pajisjeve teknike në obstetrikë);
- Analgezi, anestezi dhe reanimacion;
- Fiziologjia dhe patologjia e foshnjës së porsalindur;
- Kujdesi dhe mbikëqyrja e foshnjës së porsalindur;
- Faktorët psikologjikë dhe socialë;

B. Trajnim praktik dhe klinik

Ky trajnim duhet të kryhet nën mbikëqyrjen e përshtatshme:

- Këshillim i grave shtatzëna që përfshin të paktën 100 ekzaminime para lindjes.
- Mbikëqyrje dhe kujdes për të paktën 40 gra shtatzëna.
- Kryerja nga studenti e të paktën 40 lindjeve; kur ky numër nuk mund të arrihet për shkak të mungesës së grave të disponueshme për lindje, ai mund të reduktohet në minimumin prej 30 lindje, me kusht që studenti të ndihmojë me 20 lindje të tjera.

- Pjesëmarrje aktive në lindje podalike. Kur kjo nuk është e mundur për shkak të mungesës së lindjeve të tilla, praktika mund të bëhet në një situatë të simuluar.

- Kryerja e epiziotomisë dhe fillimi i suturimit. Fillimi duhet të përfshijë leksione teorike dhe praktikë klinike. Praktika e qepjes përfshin qepjen e plagës pas një epiziotomie dhe çarjeje të thjeshtë perineale. Kjo mund të jetë në një situatë të simuluar, nëse është absolutisht e nevojshme.

- Mbikëqyrje dhe kujdes ndaj 40 grave në rrezik gjatë shtatzënisë, lindjes ose periudhës pas lindjes.

- Mbikëqyrje dhe kujdes (duke përfshirë ekzaminimin) për të paktën 100 gra pas lindjes dhe për foshnja të porsalindura të shëndetshme.
- Vëzhgim dhe kujdes ndaj të porsalindurit që kërkojnë kujdes të veçantë, duke përfshirë foshnjat e lindura para kohe, pas lindjes, nën peshë ose të sëmurë.
- Kujdes ndaj grave me gjendje patologjike në fushën e gjinekologjisë dhe obstetrikës.
- Fillimi i kujdesit në fushën e mjekësisë dhe kirurgjisë. Fillimi duhet të përfshijë udhëzime teorike dhe praktikë klinike.

Trajnimi teorik dhe teknik (Pjesa A e programit të trajnimit) duhet të jetë i balancuar dhe i koordinuar me trajnimin klinik (Pjesa B e të njëjtit program) në mënyrë që njohuritë dhe përvoja e renditur në këtë aneks të mund të fitohen në mënyrë të përshtatshme.

Udhëzimi klinik do të marrë trajtën e trajnimit të mbikëqyrur gjatë shërbimit në pavione të spitalit ose shërbime të tjera shëndetësore të miratuara nga autoritetet ose organet kompetente. Si pjesë e këtij trajnimi, studentët mami do të marrin pjesë në veprimtarët e pavioneve përkatëse në masën që këto veprimtari kontribuojnë për trajnimin e tyre. Atyre do t'u mësohen përgjegjësitë e përfshira në veprimtaritë e mamive.

Neni 5

Dëshmi të kualifikimeve formale të mamive

Pala	Dëshmia e kualifikimeve formale	Organi që jep kualifikimet	Titulli profesional	Data e referencës

SHTOJCA IV

FARMACISTËT

Të gjitha dispozitat në shtojcën IV janë marrë nga Direktiva e BE-së 2005/36/KE, "Për njohjen e kualifikimeve profesionale", e ndryshuar nga Direktiva e BE-së 2013/55/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 nëntor 2013.

Neni 1

Trajnimi si farmacist

1. Pranimi në një kurs trajnimi si farmacist varet nga zotërimi i kualifikimit ose certifikatës që siguron akses, për studimet në fjalë, në universitete, institucione të arsimit të lartë të një niveli të njohur si ekuivalent ose një institucion nën mbikëqyrjen e një universiteti.

2. Dëshmia e kualifikimeve formale si farmacist dëshmon trajnimin me kohëzgjatje të paktën pesëvjeçare, i cili mund të shprehet edhe me kreditet ekuivalente ECTS, duke përfshirë të paktën:

a) katër vjet trajnim teorik dhe praktik me kohë të plotë në një universitet ose institucion të arsimit të lartë të një niveli të njohur si ekuivalent, ose në një institucion nën mbikëqyrjen e një universiteti;

b) gjatë ose në fund të trajnimit teorik dhe praktik, stazh gjashtëmujor në një farmaci e cila është e hapur për publikun ose në një spital nën mbikëqyrjen e departamentit farmaceutik të atij spitali.

Cikli i trajnimit i përmendur në këtë paragraf, do të përfshijë të paktën programin e përshkruar në nenin 3, të shtojcës IV.

3. Trajnimi për farmacist ofron siguri që personi në fjalë ka fituar njohuritë dhe aftësitë e mëposhtme:

a) njohuri të përshtatshme për barnat dhe substancat e përdorura për prodhimin e barnave;

b) njohuri të përshtatshme për teknologjinë farmaceutike dhe testimin fizik, kimik, biologjik dhe mikrobiologjik të produkteve medicinale;

c) njohuri të përshtatshme mbi metabolizmin dhe efektet e produkteve medicinale dhe të veprimit të substancave toksike dhe përdorimit të produkteve medicinale;

- d) njohuri të përshtatshme për të vlerësuar të dhënat shkencore në lidhje me barnat, në mënyrë që të jetë në gjendje të ofrojë informacionin e duhur mbi bazën e këtyre njohurive;
- e) njohuri të përshtatshme për kërkesat ligjore dhe të tjera që lidhen me ndjekjen e farmacistë.

Neni 2

Ndjekja e veprimtarive profesionale si farmacist

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, veprimtaritë e një farmacisti janë ato, qasja dhe ndjekja e të cilave varet nga kualifikimet profesionale dhe të cilat janë të hapura për mbajtësit e dëshmimeve të kualifikimeve formale të llojeve të renditura në nenin 4, të shtojcës IV.

2. Palët do të sigurojnë që mbajtësit e provave të kualifikimeve formale në farmaci në nivel universitar ose të një niveli të njohur si ekuivalent që plotëson kërkesat e nenit 1, të shtojcës IV, të jenë në gjendje të kenë akses dhe të ndjekin të paktën veprimtaritë e mëposhtme, në varësi të kërkesës, kur është e përshtatshme, për përvojë shtesë profesionale:

- a) përgatitjen e formës farmaceutike të produkteve medicinale;
- b) prodhimin dhe testimin e produkteve medicinale;
- c) testimin e produkteve medicinale në një laborator për testimin e produkteve medicinale;
- d) magazinimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e produkteve medicinale në fazën e shitjes me shumicë;
- e) furnizimin, përgatitjen, testimin, ruajtjen, dhe shpërndarjen e produkteve medicinale të sigurta dhe efikase të cilësisë së kërkuar në barnatore të hapura për publikun;
- f) përgatitjen, testimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e produkteve medicinale të sigurta dhe efikase të cilësisë së kërkuar në spitale;
- g) ofrimin e informacionit dhe këshillave për produktet medicinale si të tilla, duke përfshirë përdorimin e duhur të tyre;
- h) raportimin e reaksioneve negative të produkteve farmaceutike tek autoritetet kompetente;
- i) mbështetje të personalizuar për pacientët që administrojnë mjekimin e tyre;
- j) kontribut në fushatat lokale ose vendase të shëndetit publik.

3. Nëse një Palë jep qasje ose lejon ndjekjen e një prej veprimtarive të një farmacisti në varësi të përvojës shtesë profesionale, përveç zotërimit të provave të kualifikimeve formale, të përmendura në nenin 3, të shtojcës IV, ajo Palë do të njohë si provë të mjaftueshme në këtë aspekt, një certifikatë të lëshuar nga autoritetet kompetente në Palën lëshuese, e cila deklaron se personi në fjalë ka qenë i angazhuar në ato veprimtari në Palën lëshuese për një periudhë të ngjashme.

Neni 3

Kurset e trajnimit për farmacistë

- Biologjia e bimëve dhe kafshëve;
- Fizikë;
- Kimi e përgjithshme dhe inorganike;
- Kimi organike;
- Kimi analitike;
- Kimi farmaceutike, duke përfshirë analizat e produkteve medicinale;
- Biokimi e përgjithshme dhe e aplikuar (mjekësore);
- Anatomi dhe fiziologji; terminologji mjekësore;
- Mikrobiologji;
- Farmakologji dhe farmakoterapi;
- Teknologji farmaceutike;
- Toksikologji;
- Farmakognozë;
- Legjislacioni dhe, sipas rastit, etika profesionale.

Baraspesha midis trajnimit teorik dhe praktik, në lidhje me çdo lëndë, duhet t'i japë rëndësi të mjaftueshme teorisë për të ruajtur karakterin universitar të trajnimit.

Neni 4

Dëshmi të kualifikimeve formale të farmacistëve

Pala	Dëshmia e kualifikimeve formale	Organi që jep kualifikimet	Titulli profesional	Data e referencës